




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



Nr _____ prot.

Tiranë, më _____ 2017

Lënda: Propozim për projektvendim

Drejtuar : Z. Gramoz Ruçi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

*Propozim për projektvendim
për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*

[Signature]

KËTU

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, depoziton për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën : Projektvendim “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.

Bashkëlidhur janë teksti i nismes dhe relacioni shoqerues i tij.

Vasilume Kyzi *[Signature]*
Jantant Balla *[Signature]*
ULSI MANJA *[Signature]*
Mehmet Kodheli *[Signature]*
Fehri Vanli *[Signature]*
C. Orji Sp. A *[Signature]*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Aneks 2

PROJEKTVENDIM

Nr...../2017

**PËR MIRATIMIN
E KODIT TË SJELLJES SË DEPUTETËVE TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës, neneve 40, 55 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Kodi është që të ndihmojë deputetët gjatë ushtrimit të detyrës duke:

- a) përcaktuar rregulla në lidhje me standardet e duhura të sjelljes gjatë ushtrimit së veprimtarisë së tyre;
- b) siguruar transparencën dhe përgjegjësinë e nevojshme për të forcuar besimin e publikut.

**Neni 2
Fusha e veprimit**

1. Kodi zbatohet për deputetët në të gjitha aspektet e jetës së tyre publike. Kodi nuk rregullon aspektet e jetës private të deputetit.
2. Detyrimet e vendosura në këtë Kod janë në përputhje me rregullat procedurale që aplikohen për të gjithë anëtarët sipas Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 3 **Parime të përgjithshme të etikës**

1. Gjatë ushtrimit të mandatit, deputeti duhet:

- a) të jetë besnik ndaj atdheut dhe popullit sipas legjislacionit në fuqi;
- b) të veprojë në interes të popullit në përgjithësi dhe në interes të zonës së tyre zgjedhore në veçanti;
- c) të zbatojë me rigorozitet Kushtetutën, ligjin, Rregulloren e Kuvendit dhe dispozitat e këtij Kodi, si dhe të veprojë në çdo rast në përputhje me besimin që i ka dhënë populli;
- d) të veprojë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që i njeh statusi i deputetit;
- dh) të veprojë në përputhje me interesin publik;
- e) të udhëhiqet nga parimet e ndershmërisë, objektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë me qëllim rritjen e besimit të publikut në veprimtarinë e Kuvendit;
- ë) të mos veprojë arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;
- f) të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë pozitën për interesin e tij privat;
- g) të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

KREU II **KONFLIKTI I INTERESAVE DHE DEKLARIMI E KONTROLLI I PASURIVE**

Neni 4 **Konflikti i interesave**

1. Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të deputetit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.
2. Rregullat, mjetet, mënyrat dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e mandatit të deputetit përcaktohen në legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesave.
3. Deputetët dorëzojnë deklaratën e plotësuar të interesave pranë Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, që është struktura përgjegjëse në shërbim të deputetëve për deklarimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 5 **Regjistri i deklarimit rast pas rasti të konfliktit të interesave**

1. Nëse gjatë shqyrtimit të projektakteve në komisione ose në seancë plenare, deputeti konstaton konfliktin e interesit, ai plotëson deklaratën e konfliktit të interesit rast pas rasti.

2. Deklarata e konfliktit të interesit rast pas rasti dorësohet pranë Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.
3. Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve mban një regjistër të veçantë për rastet e deklarimit të konfliktit të interesit rast pas rasti.

Neni 6

Deklarimi dhe kontrolli i pasurive

1. Rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për deputetët, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta përcaktohen në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).
2. Deputetët dorëzojnë deklaratën e plotësuar të pasurisë dhe detyrimeve financiare pranë Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, që është struktura përgjegjëse në shërbim të deputetëve për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve financiare.
3. Deputeti kërkon këshillim për plotësimin e deklaratës nga Shërbimi i Burimeve njerëzore dhe trajtimit të deputetëve.

Neni 7

Kufizime gjatë ushtrimit të mandatit

Gjatë ushtrimit të mandatit, deputetit nuk i lejohet:

- a) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;
- b) të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;
- c) të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

Neni 8

Dhuratat dhe përfitime të tjera të ngjashme

1. Deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat.
2. Deputeti, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet:
 - a) t'i refuzojë ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose, në pamundësi, t'i dorëzojë zyrtarisht pranë Shërbimit të Financës dhe Buxhetit, të cilat më pas përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit;
 - b) në rast se ofrimi ose dhënia e të mirave të sipërpërmendura lidhen me kryerjen e një vepre penale, ta kallëzojë atë tek organet kompetente për ndjekje penale.

3. Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeale apo historike, u dorëzohen institucioneve të specializuara.

4. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen deputetit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në raste kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si deputet.

5. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e ftesave të zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normale të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi mënyrën e ushtrimit të detyrës së deputetit.

6. Deputeti mund të pranojë dhurata nga qeveritë e huaja apo organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, apo protokollit, nëse nuk:

a) tejkalohe kufijtë e traditës dhe të zakoneve të vendit ku jepen;

b) vënë në dyshim objektivitetin dhe ndershmërinë e deputetit;

c) kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë.

KREU III VEPRIMTARITË JASHTËPARLAMENTARE

Neni 9

Veprimtaritë jashtëparlamentare të deputetit

1. Veprimtaria jashtëparlamentare e deputetit është çdo lloj veprimtarie, që deputeti zhvillon jashtë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar.

2. Deputeti mund të ushtrojë veprimtari të tjera të ligjshme jashtëparlamentare, nëqoftëse një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesash me detyrën e tij zyrtare dhe nuk vjen në kundërshtim me kufizimet e nenit 6 të këtij Kodi.

3. Në rast të kryerjes së një veprimtarie jashtëparlamentare sipas pikës 2 të këtij neni, deputeti njofton Kryetarin e Kuvendit.

KREU IV DETYRIME TË TJERA

Neni 10

Rregullat e sjelljes në Kuvend

1. Deputeti nuk duhet:

a) të shprehet me fjalë të pahijshme dhe ofenduese në Kuvend;

b) të pengojë ose të cenojë rregullin e zhvillimit të punimeve të Kuvendit;

c) të përdorë fjalë fyese që cenojnë personalitetin e drejtuesit të seancës;

- ç) të kërcënojë apo fyejë deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe personalitetet e tjera të larta shtetërore;
 - d) të përdorë një gjuhë të shprehuri, e cila promovon urrejtjen në bazë të racës, fesë, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, prejardhjes sociale, aftësisë fizike ose mendore;
 - dh) të ndërmarrë veprime apo sulme personale ndaj ndonjë deputeti tjetër;
 - e) të bëjë thirrje për përdorim dhune në Kuvend;
 - ë) të shfaqë asnjë formë diskriminimi dhe stereotipizimi në gjuhën e përditshme, në fjalime politike, apo edhe gjatë diskutimit të projektaktve në Kuvend.
2. Deputeti duhet të përfshijë dhe trajtojë shqetësimet dhe nevojat e veçanta si të grave ashtu edhe të burrave, pa diskriminim, në komisionet parlamentare, debatet, planet e veprimit, raportet e komisioneve dhe aktet ligjore.
3. Në rast të shkeljes së pikës 1 të këtij neni, ndaj deputetit zbatohen masat disiplinore sipas procedurave të përcaktuara në Pjesën e Parë, Kreu IX të Rregullores së Kuvendit.

Neni 11 **Rregulla të tjera të sjelljes**

1. Gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvendit në komisione dhe seancë plenare, deputeti duhet të paraqitet me veshje zyrtare.
2. Gjatë zhvillimit të seancave plenare dhe mbledhjeve të organeve të Kuvendit, si rregull, deputeti nuk duhet të përdorë telefoninë e lëvizshme.

Neni 12 **Transparenca e veprimitarisë parlamentare të deputetit**

1. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deputeti duhet të jetë transparent në komunikimin me zgjedhësit, me median dhe me publikun.
2. Byroja e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi për deputetët në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.

Neni 13 **Ruajtja e informacionit të klasifikuar**

1. Deputeti ruan konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, për shkak të funksionit që ai kryen, pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislati në fuqi.
2. Pas mbarimit të mandatit, deputeti nuk duhet ta përdorë për interes personal informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 14
Kufizim pas mbarimit të mandatit

Deputeti, të cilit i ka mbaruar mandati, nuk mund të veprojë si një avokat i paguar në ndonjë çështje ku Kuvendi është palë ose subjekt i interesuar, deri në 3 vjet pas mbarimit të mandatit.

Neni 15
Autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit

Byroja e Kuvendit është autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij Kodi Sjelljeje.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz RUÇI

RELACION

**PËR PROJEKTVENDIMIN PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES SË
DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Parlamenti, me funksionet e tij kushtetuese të përfaqësimit të sovranitetit të popullit, të hartimit të legjislacionit, të mbikëqyrjes, të hartimit të politikave prioritare për shpërndarjen e burimeve kombëtare, etj. është institucioni thelbësor për qeverisjen demokratike. Aftësia e një parlamenti për të kryer këto funksione nuk varet vetëm nga kapaciteti teknik, por edhe legjitimiteti i tij.

Legjitimiteti në vetvete varet edhe nga fakti sesi qytetarët i perceptojnë institucionet parlamentare dhe vetë parlamentarët, si veprojnë ata në përputhje me interesat e publikut krahasuar me interesat private apo politike, partiake. Në doktrinën politike është rënë dakord, gjerësisht, se parlamentet duhet të nxisin integritetin, legjitimitetin dhe besimin e qytetarëve tek vlerat e një sistemi demokratik qeverisjeje.

Një përpjekje e rëndësishme për të ndërtuar besimin e publikut tek parlamenti, për të forcuar integritetin dhe transparencën në sistemin e qeverisjes dhe për të konsoliduar institucionet kombëtare demokratike është edhe miratimi i këtij Kodi Sjelljeje për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Miratimi i këtij akti rregullator (dokumenti) do të shërbejë si në drejtim të përmirësimit të standardeve etike dhe performancës së deputetëve, ashtu edhe në drejtim të rifitimit të besimit të qytetarëve në sistemin politik në përgjithësi dhe në institucionin e parlamentit në veçanti.

Fillesa për hartimin e këtij Kodi gjendet në nenin 40 të Rregullores së Kuvendit, i cili në pikën 3 të tij shprehet: *“Anëtarët e Kuvendit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes”*. Më tej në një kre të veçantë, në kreun IX, Rregullorja shprehet për rregullin dhe sjelljen në Kuvend, duke përcaktuar qartë se cila duhet të jetë sjellja e deputetëve gjatë zhvillimit të seancës plenare dhe cilat janë rastet konkrete kur penalizohen veprime të caktuara të deputetëve. Gjithashtu, rregulla konkrete dhe të detyrueshme për tu zbatuar nga deputetët janë të përcaktuara edhe në ligje të tjera të posaçme si: Ligji “Për statusin e deputetit”, i ndryshuar; ligji **Nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”**, i ndryshuar; ligji **nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”**, i ndryshuar, **“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”**, etj.

Bazuar në këto përcaktime, mund të lindë natyrshëm pyetja: Pse nevojitet atëherë ky Kod Sjelljeje? Argumentat, pro miratimit të këtij akti janë të shumtë, por në këtë relacion po ndalemi tek ato më kryesoret. Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë organizon kuadrin etik të institucionit në një dokument të vetëm dhe gjithëpërfshirës: ai ofron rregulla dhe udhëzime për deputetët se si të veprojnë në raste të caktuara për zgjidhjen e dilemave etike dhe për adresimin dhe parandalimin e konflikteve të interesit . Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ajo që shpesh është e lejuar me ligj, nuk mund të jetë domosdoshmërisht etike. Prandaj, ky Kod siguron qartësi në këto lloj çështjesh, duke identifikuar edhe mënyrat e veprimit të administratës së Kuvendit në shërbim të deputetëve. Qëllimi i këtij Kodi është që të ndihmojë deputetët gjatë ushtrimit të detyrës në Kuvend dhe në zonat elektorale, duke dhënë udhëzime në lidhje me standardet e duhura të sjelljes gjatë ushtrimit të detyrës parlamentare dhe publike (neni 1). Ky Kod thekson transparencën për mënyrën sesi deputeti e ushtron detyrën e tij, si një parim themelor në bazë të të cilit ndërtohet marrëdhënia mes tij dhe publikut. Kodi zbatohet për anëtarët e Kuvendit në të gjitha aspektet e jetës së tyre publike, por përjashton nga rregullimi, aspektet e jetës thellësisht private të deputetit (neni2) .

Rregullimi i standardeve etike dhe të sjelljes luan një rol të rëndësishëm në garantimin se sjellja e deputetëve nuk është vetëm në përputhje me Kushtetutën apo ligjet e një vendi, por që gjithashtu i plotëson pritshmëritë e publikut për të. Shpesh, votuesit presin që deputetët të japin llogari për mënyrën sesi po e ushtrojnë mandatin e tyre dhe jo vetëm për veprime apo lëvizje të caktuara politike, por edhe të sjelljes së tyre, apo për shembull për shpenzimet që ka kryer Kuvendi si institucion për pagat e deputetëve, për dietat e tyre, për strehimin, etj. Sistemimi i këtyre rregullave në një dokument të vetëm siguron një pikë referimi për të përcaktuar vlerat dhe parimet e përgjithshme të sjelljes, gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit. Standardet e qarta dhe të integruara lehtësojnë funksionimin e një sistemi demokratik, pasi kjo ndihmon institucionet e tjera për të mbikëqyrur veprimtarinë e deputetëve dhe të vetë Kuvendit. Kështu, ky Kod do të jetë një dokument i rëndësishëm referimi për mediet, apo organizatat jofitimprurëse, të cilat mbikëqyrin dhe informojnë në të njëjtën kohë edhe publikun në mënyrë intensive për jetën parlamentare dhe politike në vend. Por, parimi i transparencës i garantuar nga ky Kod, njëkohësisht mbron deputetët dhe Kuvendin nga çdo akuzë false në drejtim të tyre. Neni 11 i Kodit përcakton se gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deputeti duhet të jetë transparent në komunikimin me zgjedhësit, me median dhe me publikun. Byroja e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi për çdo deputet në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj. Këto

shpenzime mund të përfshijnë : pagën, dietat, karburantet, shpenzimet e telefonit, të strehimit, etj.

Hartimi i këtij Kodi Sjelljeje do të jetë një gur nismëtar në përpjekjet e Kuvendit për të luftuar korrupsionin. Funkzioni themelor i Kuvendit në miratimin e ligjeve antikorrupsion dhe në mbikëqyrjen e institucioneve publike që i zbatojnë ato, nuk mund të jetë efektiv nëse vetë ligjvënësit nuk i kanë të qarta rregullat e sjelljes për veprimtarinë e tyre. Standardet e qarta dhe lehtësisht të identifikueshme për mënyrën se si duhet të sillen deputetët mund të ndihmojnë për të parandaluar shpërdorimin e detyrës dhe format e tjera të korrupsionit. Këto standarde të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme do të ofrojnë qartësi më të madhe për deputetët dhe administratën e Kuvendit në shërbim të tyre, për mënyrat e sjelljes në raste të caktuara. Për shkak të pozicionit të veçantë që kanë si përfaqësues të popullit, deputetët përballen vazdimisht me dilema etike. Atyre u duhet shpesh të zgjedhin midis interesave të ndryshme konkurruese: kombëtare, të zonës zgjedhore, politike, partiake apo personale. Në kreun II, Kodi trajton pikërisht këto çështje të konfliktit të interesave. Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të deputetit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Rregullat, mjetet, mënyrat dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e mandatit të deputetit përcaktohen në legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesave (neni 4) . Kodi përcakton se Shërbimi i Burimeve njerëzore dhe trajtimit të deputetëve është struktura përgjegjëse në shërbim të deputetëve për deklarimin e rasteve të konfliktit të interesave. Ky shërbim mbledh dhe dërgon në ILDKPKI, brenda datës 15 prill të çdo viti, deklaratat e plotësuara të interesave, si dhe njofton rastet e mosdeklarimeve. Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur (neni 5). Shërbimi i Burimeve njerëzore dhe trajtimit të deputetëve është struktura përgjegjëse në shërbim të deputetëve për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve financiare. Ky shërbim përpara deklarimit, duhet t'i japë deputetit të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëjë të njohura atij pasojat që mbart deklarimi i rremë. Shërbimi i Burimeve njerëzore dhe trajtimit të deputetëve mbledh dhe dërgon në ILDKPKI,

brenda datës 15 prill të çdo viti, deklaratat e plotësuara, si dhe njofton rastet e mosdeklarimeve.

Kodi vendos kufizime për aktivitete që deputeti nuk lejohet të kryejë gjatë ushtrimit të mandatit (neni 6). Deputetit nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse. Ai nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër. Deputeti nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

Doktrina politike dhe sidomos ajo mbi etikën dhe sjelljen në parlament e konsideron marrjen e dhuratave si një moment problematik për ligjvënësit. Dhënia e dhuratave për udhëheqësit politikë është një praktikë e hershme përgjithësisht e preceptuar si shprehje respekti kundrejt tyre. Por jo rrallë këto dhurata përfaqësojnë edhe kompensime për favore politike ose ekonomike. Me qëllim që të mbrojnë deputetët dhe integritetin e tyre, Kodi përcakton rregulla të qarta në lidhje me dhuratat dhe përfitimet e tjera të ngjashme (neni7). Deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat. Deputeti, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, duhet t'i refuzojë ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose, në pamundësi, t'ia dorëzojë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit urdhëron vlerësimin dhe inventarizimin e dhuratave, të cilat më pas përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit. Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeale apo historike, u dorëzohen institucioneve të specializuara;

Kodi në vendosjen e këtyre rregullave ka mbajtur parasysh traditën dhe zakonet morale të sjelljes së shoqërisë sonë, prandaj bën edhe përcaktimin se cilat nuk konsiderohen dhurata në kuptimin e kufizimit të marrjes së tyre. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të përfitimeve të padrejta për shkak të pozicionit, dhuratat, të cilat i ofrohen deputetit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rasti kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si deputet. Gjithashtu kufizimet në pranimin e dhuratave nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes,

brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi mënyrën e ushtrimit të detyrës së deputetit. Për shkak të statusit të veçantë që gëzon, deputeti gjendet shpesh në marrëdhënie protokollare me përfaqësues të qeverive të huaja apo organizatave ndërkombëtare. Parashikimet e këtij Kodi kanë qenë të kujdesshme edhe në këtë pikë, duke përcaktuar se, deputeti mund të pranojë dhuratat nga qeveritë e huaja apo organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, kortezisë apo protokollit, nëse nuk tejkalohen kufijtë e traditës dhe të zakoneve të vendit ku jepen, nuk vënë në dyshim objektivitetin dhe ndershmërinë e deputetit dhe nëse nuk kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë. Kuvendi mban Regjistrin e dhuratave të deputetëve. Këto janë dhuratat, të cilat i lejohen deputetëve t'i marrin gjatë ushtrimit të mandatit. Dhuratat deklarohen nga vetë deputeti. Ky regjistër i dhuratave administrohet dhe përditësohet nga Sektori i Trajtimit të Deputetëve.

Historikisht, deputetët vijnë në Kuvend nga përvoja jetësore dhe eksperiencia profesionale të ndryshme. Në konfigurimin e Kuvendit si një i tërë, ky varietet është i rëndësishëm, pasi shpreh aftësinë e institucionit për të përfaqësuar zgjedhësit. Megjithatë në Kuvend, deputetët do t'i binden rregullave të njëjta, që tashmë lidhen me funksionin e deputetit, Kodi mban në konsideratë edhe *background*-in profesional të deputetëve, prandaj parashikon edhe se cilat mund të jenë veprimtaritë jashtëparlamentare të deputetit (neni 8). Veprimtaria jashtëparlamentare e deputetit është çdo lloj veprimtarie, që deputeti zhvillon jashtë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar. Deputeti mund të ushtrojë veprimtari të tjera të ligjshme jashtëparlamentare, nëqoftëse një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesash me detyrën e tij zyrtare dhe nuk vjen në kundërshtim me kufizimet e këtij Kodi. Në rast të kryerjes së një veprimtarie jashtëparlamentare sipas pikës 2 të këtij neni, deputeti njofton Kryetarin e Kuvendit. Kuvendi mban Regjistrin e Veprimtarive Jashtëparlamentare. Deputetët që ushtrojnë veprimtari jashtëparlamentare, pasi kanë njoftuar Kryetarin e Kuvendit, përfshihen në Regjistrin e Veprimtarive Jashtëparlamentare. Regjistri i Veprimtarive Jashtëparlamentare administrohet dhe përditësohet nga Sektori i Trajtimit të Deputetëve.

Një arsye tjetër mbi rëndësinë e hartimit të rregullave dhe standardeve të sjelljes parlamentare është dhe rritja e shkallës së profesionalizmit në politikë . Shumë profesione kanë sistemet e standardeve (kode etike) të cilat udhëheqin aktivitetin e anëtarëve të tyre, si nëpunësit civilë, mjekët, avokatët, etj. Ashtu si anëtarët e profesioneve të tjera , deputetët gjithashtu duhet të bien dakord që të sillen në mënyrë profesionale, për të kryer në mënyrë efektive dhe etike detyrat e tyre.

Kodi vendos parimet e përgjithshme të etikës gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit, të cilat janë në përputhje me parimet kushtetuese dhe të legjislacionit tonë të brendshëm (neni 3). Mund të përmendim disa nga këto parime si: deputeti duhet të jetë besnik ndaj atdheut dhe kombit sipas legjislacionit në fuqi; të veprojë në interes të kombit në përgjithësi dhe në interes të zonës zgjedhore në veçanti; të veprojë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që i njeh statusi i deputetit; të udhëhiqet nga parimet e ndershmërisë, objektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë me qëllim rritjen e besimit të publikut në veprimtarinë e Kuvendit; të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;

Në demokracinë tonë të re, hartimi i këtij Kodi mund të shërbejë si qëllim për të transformuar kulturën ekzistuese, por mund të jetë edhe më ambicioz - për të ndërtuar një kulturë të re politike. Kodi përsa i përket rregullave të sjelljes në Kuvend, në kuptimin e ngushtë të saj, paraqet një risistemim të përcaktimeve të Rregullores së Kuvendit për këtë çështje. Mbahen parasysh parimet e vendosura se Deputeti nuk duhet të shprehet me fjalor të pahijshëm dhe ofendues në Kuvend; të pengojë ose të cenojë rregullin e zhvillimit të punimeve të Kuvendit; të përdorë fjalë fyese që cenojnë personalitetin e drejtuesit të seancës; të kërcënojnë apo fyejnë deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe personalitetet e tjera të larta shtetërore; të ndërmarrë veprime apo sulme personale ndaj ndonjë deputeti tjetër; të bëjnë thirrje për përdorim dhune në Kuvend. Për të gjitha këto raste ndaj deputetit zbatohen masat disiplinore sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu risillen në vëmendjen e deputetëve dhe rregullat mbi paraqitjen me veshje zyrtare, përdorimin e telefonisë së lëvizshme dhe ndalimin e pirjes së duhanit gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvendit, apo në mjediset e tij.

Në momentin që bëjnë betimin, pra fillojnë ushtrimin e mandatit, deputetët nuk janë shumë të qartë për atë se çfarë pritet prej tyre si anëtarë të Kuvendit. Për këtë arsye, Kuvendi organizon çdo fillim legjislature, trajnime mbi administratën e Kuvendit, si dhe mbi aspekte të veprimtarisë parlamentare në ndihmë të deputetëve, të cilët janë anëtarë për herë të parë. Por rregullat mbi ushtrimin e mandatit, siç u theksua edhe më sipër janë të shpërndara në akte të ndryshme rregulluese dhe përmbledhja e tyre në një akt të vetëm përbën një lehtësi për të gjithë deputetët, duke shërbyer si udhërrëfyes në çështjet e etikës parlamentare.

Komuniteti me të drejtë ka pritshmëri të larta për mënyrën e sjelljes së deputetit, pasi i ka dhënë besimin për ta përfaqësuar. Miratimi i një kodi sjelljeje, do ti japë mundësinë komunitetit të zonës zgjedhore, të ketë më të qarta pritshmëritë ndaj sjelljes së deputetit dhe sigurisht kjo do të ndikojë në rritjen e përgjegjshmërisë së deputetit ndaj zgjedhësve.

Miratimi i një kodi sjelljeje nga deputetët për vetë deputetët është një tregues i përgjegjësisë së tyre për funksionin dhe statusin që gëzojnë dhe për respektimin e vlerave të institucionit të Kuvendit në tërësi.

Kodi vendos disa kufizime për deputetët edhe pas mbarimit të mandatit (neni 13). Deputeti, të cilit i ka mbaruar mandati, nuk mund të veprojë si një avokat i paguar në ndonjë çështje ku Kuvendi është palë ose subjekt i interesuar, deri në 3 vjet pas mbarimit të mandatit. Gjithashtu, pas mbarimit të mandatit deputeti nuk duhet ta përdorë informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës për interes personal.

Hartimi i këtij Kodi është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për standartet e hartimit të Kodeve të Sjelljes për parlamentarët. Janë marrë në konsideratë: studimi i OSBE/ODHIR “Standardet etike dhe profesionale për parlamentarët”, Varshavë 2012 si dhe përfundimet e Konferencës së OSBE-së “Standardeve e Etikës dhe sjelljes për parlamentarët”, Beograd, nëntor 2011, si dhe Konferenca e mbajtur në Tiranë në korrik të vitit 2012 me të njëjtën tematikë. Gjithashtu, në maj 2015, Kuvendi, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Tiranë organizuan një tryezë pune për finalizimin e projektit të Kodit të sjelljes, pas ekspertizës së oftuar nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në Varshavë.

Janë studiuar dhe kanë shërbyer si udhëzues edhe praktikat më të mira të vendeve si Mbretëria e Bashkuar, Polonia apo edhe Kodi i Sjelljes së Parlamentit Europian.

Por miratimi i këtij Kodi, i cili promovon integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë e deputetëve gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, është edhe një shprehje e implementimit dhe respektimit të standardeve dhe normave ndërkombëtare. Përmendim këtu: Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1214/2000 për rritjen e konsensusit ndërkombëtar për nevojën e një mekanizmi për deklarimin e interesave në sjelljen parlamentare; Konventa e OKB-së kundër korrupsionit, 2005; Deklarata e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Bruksel 2006, mbi rekomandimet për rregullimin e standardeve profesionale për parlamentarët; etj.

Në lidhje me mënyrën e hartimit dhe miratimit të këtij Kodi është menduar që ai të paraqitet në formën e një vendimi të Kuvendit, si aneks nr. 2 i Rregullores së Kuvendit, në mënyrë që këto rregulla dhe standarde të bëhen pjesë e saj. Kjo vjen në përputhje të plotë edhe me nenin 74/2 të Kushtetutës i cili parashikon: “*Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve*”. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij Kodi është Byroja e Kuvendit.

Detyrimet e vendosura në këtë kod janë në përputhje me të gjitha rregullat procedurale që aplikohen për të gjithë anëtarët sipas Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit dhe legjislacionit në fuqi.